

# ? SI MUND TË NA KONTAKTONI

Dhënia e mendimit, komenteve mbi punën tonë dhe ankesave është e drejta juaj.



Ne i mirëpresim **sugjerimet, komentet, mendimet dhe ankesat tuaja** në mënyrë që të përmirësojmë punën tonë.



Ju mund të lidheni me ne përmes linjës telefonike  
**068 40 75 263**, nga e hëna në të premte, ora **09.00-15.00**  
dhe përmes emailit **[llogaridhenia@wvi.org](mailto:llogaridhenia@wvi.org)**

World Vision 

## Mekanizmi i Llogaridhënies

WORLD VISION  
SHQIPËRI DHE KOSOVË



World Vision 

*Sugjerimet, mendimet, komentet dhe ankesat tuaja do të regjistrohen dhe ju do të merrni një përgjigje duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit dhe anonimatit.*

# RRETH WORLD VISION SHQIPËRI DHE KOSOVË

World Vision është një organizatë ndërkombëtare humanitare e krishterë, zhvillimi komunitar dhe advokuese.

Në Shqipëri, World Vision filloi të punonte në 1999-ën, si përgjigje ndaj krizës së refugjatëve kosovarë. Prej dy dekadash, puna jonë është fokusuar tek zhvillimi dhe mbështetja afatgjatë për fëmijët, adoleshentët e të rinjtë dhe komunitetet më në nevojë në Shqipëri.

**Puna jonë ndikon në jetën e mbi 60 mijë fëmijëve dhe 43,000 të rriturve, në 24 bashki.**

**60.000**  
të rinj



**43.000**  
të rritur



Ne mbështesim dhe punojmë për fuqizimin e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve më në nevojë. Mbrojtja e përfshirja sociale, aktivizmi rinor dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik për familjet në nevojë janë fokusi i punës sonë. World Vision angazhohet për të sjellë ndryshim të qëndrueshëm dhe ritjen e mirëqënies për fëmijët dhe familjet në Shqipëri.



## SJELLJET E PRITSHME

**Punonjësit e World Vision Shqipëri dhe Kosovë dhe partnerët tanë:**

- Duhet të trajtojnë çdo njeri me respekt, dinjitet dhe paanshmëri.
- Duhet të sillen në mënyrë të besueshme dhe etike.
- Nuk duhet të përdorin dhunë, kërcënim apo të përfshihen në sjellje të dhunshme.
- Nuk duhet të kenë sjellje/qëndrime/marrëdhënie që favorizojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve (personave nën 18 vjeç) apo të përfituesve të programit/projektit.

## PROGRAMI YNË SYNON

Fëmijët në Shqipëri dhe Kosovë të jetojnë në një mjedis gjithëpërfshirës, të sigurt dhe të mbrojtur, me mundësi për të ardhmen e tyre.

 **Shqipëri**

 **Kosovë**

World Vision në Shqipëri dhe Kosovë punon në tre sektorë:

 **Mbrojtja e fëmijëve**

 **Edukimi dhe Rinia**

 **Zhvillimi ekonomik dhe rezilienca në komunitet**

Në këtë kuadër kjo fletëpalosje ka si qëllim informimin e fëmijëve, të rriturve, të çdo partneri apo donatori mbi ekzistencën e Mekanizmit të Llogaridhënies në World Vision Shqipëri dhe Kosovë. Kjo është një mundësi që u jepet të adresojnë në mënyrën e duhur sugjerimet, mendimet, komentet dhe ankesat që ata mund të kenë për projektet/programet e World Vision Shqipëri dhe Kosovë.